



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201402346/15

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve.*

Drejtuar : Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
Z. Edi RAMA

Tiranë

I nderuar zoti Kryeministër,

Në institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë një grup punonjësish të Policisë së Burgjeve. Ankuesit shkruajnë se, punonjësve të Policisë së Burgjeve po u shkelen të drejtat e garantuara nga ligji dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e kësaj strukture. Ndërkohë ata parashtrojnë disa nga problemet që hasen në punën e përditshme të punonjësve të Policisë së Burgjeve të cilat janë:

1. Nuk paguhet shtesa e pagës për oficerët e policisë që transferohen me shërbim jashtë rrethit.
2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk e kanë marrë uniformën që prej 5 vjetësh.
3. Atyre nuk u jepet ushqimi që prej 10 vjetësh.
4. Orët shtesë, të cilat në disa sektorë shkojnë deri 12 orë në ditë, nuk u paguhen dhe ndërkohë ato nuk kompensohen me pushim.
5. Nuk paguhet leja vjetore e pa kryer për nevoja pune.
6. Nuk paguhet vjetërsia në punë, me përjashtim të 3 viteve të fundit.

Përveç sa më sipër, ankuesit ngrenë edhe shqetësimin që u krijohet nga aktet normative në fuqi, për trajtimin jo të barabartë të tyre me punonjësit e Policisë së Shtetit. Ndërkohë lidhur me këtë çështje ata sqarojnë se, në Itali, Greqi dhe në disa vende të tjera të BE-së, punonjësit e Policisë së Burgjeve paguhen 10% më shumë sesa punonjësit e policisë së rendit. Ndërsa në vendin tonë ata paguhen 30 % më pak se punonjësit e Policisë së Shtetit ndonëse kushtet e punës i kanë jo të mira, për të mos thënë më të këqia. Sipas tyre, edhe në kohën e monizimit punonjësit e Policisë së Burgjeve paguheshin 10 % më shumë sesa punonjësit e policisë së rendit.

Gjithashtu në këtë ankesë ata ngrenë edhe problemin e ndryshimit të strukturës organike, duke shtuar numrin e punonjësve të Policisë së Burgjeve në disa sektorë shërbimi, ku kryerja e detyrës ka shumë vështirësi.

Nisur nga ky rast dëshirojmë që t'ju sjellim në vëmendje se, në veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk kanë qenë vetëm objekt i punës së këtij institucioni, por edhe subjekte që gëzojnë të drejtën ligjore t'i drejtohen atij. Ankesat e punonjësve administratës publike duke përfshirë edhe ata të Policisë së Burgjeve janë vlerësuar dhe do të vlerësohen me prioritet e përkushtim nga ana jonë. Ne gjykojmë se, përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve të garantuara nga ligji organik dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të kësaj strukture do të sjellë me siguri motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Burgjeve, të përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, *për garantimin e rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të paraburgosurve dhe të dënuarve.*

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën 447/1 Prot., datë 20.01.2015, lidhur me këtë ankesë na informoi se:

1. Shtesa e pagës për oficerët e Policisë së Burgjeve, të cilët transferohen me shërbim jashtë rrethit ku kanë vendbanimin nuk mund të bëhet pasi një e drejtë e tillë nuk është parashikuar në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar.

2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk e kanë marrë uniformën e parashikuar nga ligji që nga viti 2009. Edhe në buxhetin e vitit 2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk është planifikuar zëri për uniformën e punonjësve të Policisë së Burgjeve.

3. Punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk u jepet ushqimi që nga muaji Korrik 2006, pasi nuk ka fonde të planifikuara për këtë qëllim.

4. Në bazë të VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar, orët shtesë nuk paguhen, por duhet të kompensohen me pushime brenda dy muajve nga koha e kryerjes së tyre.

5. Në bazë të VKM-së të cituar më lartë, nuk lejohet kompensimi në lekë për lejen vjetore të pa kryer, por ajo jepet brenda muajit mars të vitit pasardhës.

6. Në bazë të VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, pika 4, dhe ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, vjetërsia 1 % për çdo vit pune përfitohet nga momenti i marrjes së gradës së re dhe kjo e drejtë përfitohet që nga data 10.07.2010, kur ka hyrë në fuqi VKM-ja.

7. Për sa përshkruhen më lartë citohen dispozitat ligjore dhe përmbajtja e tyre dhe konkretisht, nenet 3/4, 13/1, 14/3 dhe 15 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar.

8. Trajtimi jo i barabartë i punonjësve të Policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit është i vërtetë dhe ka kjo ndodhur pas miratimit të VKM nr. 93, datë 19.02.2014 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1135, datë 05.08.2008 "Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit". Me këtë vendimin

pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit u rritën ndërsa pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk ndryshuan.

Gjithashtu për këtë problem na informoi se, gjatë viteve 2004-2006 pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve kanë qënë më të larta se pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit.

9. Ndërsa lidhur me problemin e ndryshimit të strukturës organike dhe shtimin e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve në disa sektorë shërbimi na informoi se, ndryshimi i strukturës organike nuk është në kompetencën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-ve e miratuar me Urdhrin nr. 50, datë 13.04.2012 të Kryeministrit është ndryshuar me Urdhrin nr. 164, datë 19.05.2014 të Kryeministrit.

Nga përgjigjia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilën e përshkruam më lart rezulton se, shumica e problemeve dhe e shqetësimeve të ngritura nga punonjësit e Policisë së Burgjeve janë të vërteta dhe qëndrojnë.

Mosdhënia e uniformës punonjësve të Policisë së Burgjeve për 6 vjet dhe të ushqimit për 9 vjet justifikohet me mungesën e fondeve në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ne vlerësojmë se ky justifikim, dhe qëndrimi që është mbajtur dhe vazhdon të mbahet ndaj këtyre problemeve, jo vetëm që nuk është i bazuar në ligj, por ai është i padrejtë dhe cënon të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Mosdhënia e uniformës sipas normave të miratuara me akte nënligjore përbën cënim të pamjes së jashtme të tyre dhe ndërkohë cënon imazhin e Policisë së Burgjeve dhe të vetë shtetit.

Gjithashtu vlerësojmë se, mosdhënia e ushqimit rëndon gjendjen ekonomike e financiare të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe për rrjedhojë cënon nivelin e jetesës dhe shëndetin e tyre. Ndërkohë kjo sjell si pasojë edhe uljen e përkushtimit dhe të performancës së tyre në punë.

Moskompensimi i orëve shtesë të punës me kohë pushimi dhe mosdhënia e pushimeve vjetore apo moskompensimi i tyre në vlerë vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar.

Sipas përgjigjes së Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, respektivisht pikave 4 dhe 5 të saj, të cilën e kemi cituar më sipër, në bazë të VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, orët shtesë dhe leja vjetore nuk paguhen, por duhet të kompensohen me pushime, përkatësisht orët shtesë brenda dy muajve dhe lejet vjetore brenda muajit mars të vitit pasardhës.

Ne vlerësojmë se kjo pjesë e përgjigjes nuk është e plotë, sepse punonjësit e Policisë së Burgjeve jo vetëm që nuk janë kompensuar në vlerë, por ata nuk janë kompensuar as me pushime. Mosdhënia e pushimeve sipas parashikimeve ligjore sjell si pasojë uljen e rezistencës dhe të aftësive fizike e

psikologjike të punonjësve të policisë dhe për rrjedhojë edhe të performancës së tyre në kryerjen e detyrës së ngarkuar me ligj.

Gjithashtu konstatojmë se kjo pikë e përgjigjes nuk është edhe plotësisht e saktë sepse:

Së pari, në nenin 14, pika 3, të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, parashikohet se: *"Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se muaji mars i vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi në vlerë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky trajtim bëhet edhe për orët shtesë të punës dhe të shërbimit."*

Së dyti, në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar, pika 5, parashikohet se: *"Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë....Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page"*.

Lidhur me trajtimin e diferencuar të punonjësve të Policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pranohet që ky fakt është i vërtetë. Sipas saj, kjo ka ndodhur pas miratimit të VKM nr. 93, datë 19.02.2014 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1135, datë 05.08.2008", të ndryshuar.

Ndërkohë në përgjigjen e dërguar citohet neni 3, pika 4, i ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Policia e Burgjeve është strukturë e depolitizuar, punonjësit e saj janë pjesë e administratës publike dhe gëzojnë të gjitha të drejtat për trajtim ekonomik - financiar, si Policia e Shteti."*

Në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk informohemi lidhur me masat që janë marrë nga ky institucion për bërë të mundur zbatimin e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve të garantuara nga ligji nr. 36/2014, megjithëse ka mbi një vit që ka hyrë në fuqi.

Ndërsa lidhur me pikën 9 të përgjigjes vlerësojmë se, ndonëse kompetencën për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-ve e ka Kryeministri, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë plotësisht të drejtën që, për të përmbushur me sukses misionin ligjor të Policisë së Burgjeve për garantimin e rendit dhe sigurisë në IEVP-të, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të paraburgosurve dhe të dënuarve, si dhe të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të bëjnë propozimet përkatëse për ndryshimin e kësaj strukture.

Ndërkohë gjykojmë se, për shkak të mbipopullimit në IEVP-të, veçanërisht vitin e fundit, kërkohet në mënyrë imediate rishikimi dhe ndryshimi i strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe rritja e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve si pjesë organike e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nga verifikimet e bëra nga institucioni ynë në disa IEVP në vend, arritëm në konkluzionin se, mosdhënia e uniformës punonjësve të Policisë së Burgjeve për 6 vjet, mosdhënia e ushqimit për 9 vjet, mosdhënia e lejes vjetore, moskompensimi me pushim për orët shtesë të punës ose moskompensimi në vlerë, si dhe mostrajtimi ekonomik-financiar në mënyrë të barabartë me punonjësit e Policisë së Shtetit, përbën shkelje të të drejtave të tyre që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe të garantuara nga Kushtetuta, ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar.

Ndodhur në këto rrethana arritëm në konkluzionin kategorik se, përderisa aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve janë në fuqi, ato duhen zbatuar me rigozitet.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: *"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit.... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*, me shkresën tonë nr. K2/G39-4 Prot., datë 27.02.2015, i rekomanduam Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si më poshtë:

1. Marrjen e menjëhershme të masave organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoritë e IEVP-ve për respektimin brenda afateve ligjore të të drejtës së punonjësve të Policisë së Burgjeve për kryerjen e lejeve vjetore të pa bëra dhe për kompensimin me pushime për orët shtesë të punës së kryer, ose në pa mundësi të bëhet kompensimi në vlerë i tyre.

2. Marrjen e masave të nevojshme dhe bërjen e propozimeve përkatëse Këshillit të Ministrave për rritjen e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të bërë të mundur respektimin e të drejtës për t'u pajisur e uniforme dhe dhënien e ushqimit punonjësve të Policisë së Burgjeve që nga koha e cënimit të tyre.

3. Marrjen e masave për përgatitjen dhe dërgimin në Këshillin e Ministrave të projektit të VKM me qëllim trajtimin e barabartë ekonomik-financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit.

4. Marrjen e masave të nevojshme studimore dhe bërjen e propozimit përkatës Kryeministrit me qëllim ndryshimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2997/1 Prot., datë 08.05.2015, ndërmjet të tjerave na informoi se:

Në lidhje me pikën e dytë të rekomandimit, kjo ministri, gjatë përgatitjes së fazës së parë dhe të fazës së dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017, ka pasqyruar në relacionin drejtuar Ministrisë së Financave, kërkesën për shtesë fondi për blerjen e uniformave për punonjësit e Policisë së Burgjeve, pasi tavani i vendosur prej tyre nuk ishte i mjaftueshëm.

Gjithashtu me shkresën nr. 5946 Prot., datë 03.09.2014, drejtuar Ministrisë së Financave, mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe me shkresën nr. 8142 Prot., datë 23.10.2014, mbi kërkesat buxhetore për vitin 2015, janë kërkuar fonde për blerjen e uniformave për Policinë e Burgjeve, kërkesë e cila nuk është miratuar.

Ndërsa për problematikën e trajtuar në pikën e tretë të rekomandimit, bazuar në nenin 4/2 të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i është drejtuar dy institucioneve përgjegjëse, Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministrisë së Financave, për të ndërmarrë iniciativën ligjore për ndryshimin e VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”. Në lidhje me këtë problem, Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike ka dhënë përgjigje miratuese, ndërsa Ministria e Financave nuk është shprehur ende.

Në vijim të ndjekjes së këtij problem, me shkresën nr. K2/G39-8 Prot., datë 21.05.2015, drejtuar Ministrit të Financave i kërkuam informacion lidhur me:

1. Ecurinë e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për rritjen e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për blerjen e uniformave për Policinë e Burgjeve.

2. Ecurinë e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”.

Ministri i Financave me shkresën nr. 7902/1 Prot., datë 28.05.2015 na informoi se:

Lidhur me pikën e parë, kërkesat buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë për vitet 2015-2017 janë trajtuar në përputhje me ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe janë miratuar sipas kërkesave të ligjit nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”. Pas miratimit të ligjit vjetor, Ministria e Financave miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara nga nëpunësi autorizues i institucionit qendror, për çdo njësi shpenzuese dhe është përgjegjëse që kjo të reflektohet në sistemin e thesarit. Detajimi i fondeve buxhetore të çdo programi dhe prioritizimi i tyre, nuk është kompetencë e Ministrisë së Financave.

Lidhur me pikën e dytë, për ndryshimin e VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, kërkohet referimi i shkresës përkatëse të dërguar nga Ministria e

Drejtësisë, pasi në këtë ministri nuk ka asnjë kërkesë të patrajtuar nga institucioni apo Departamenti i Administratës Publike.

Për sa më lart, me shkresën tonë K2/G39-11 Prot., datë 22.06.2015, drejtuar Ministrit të Drejtësisë i kërkuam informacion shtesë lidhur me numrin e protokollit dhe datën e shkresave që Ministria e Drejtësisë i ka dërguar Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike, si dhe Ministrisë së Financave për ndërmarrjen e nismës ligjore për ndryshimin e VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve".

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 4400/1 Prot., datë 07.07.2015, na informoi se kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndërmarrjen e nismës ligjore për ndryshimin e VKM nr. 1061, datë 08.07.2010, "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve", i është dërguar Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike, si dhe Ministrisë së Financave me shkresën nr.1382/2 Prot., datë 03.03.2015.

Pasi morëm këtë informacion nga Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. K2/G39-13 Prot., datë 22.09.2015, ia dërguam atë Ministrit të Financave duke i bashkëlidhur edhe fotokopjen e shkresës së Ministrisë së Drejtësisë nr. 4400/1 Prot., datë 07.07.2015.

Ministri i Financave me shkresën nr. 7902/3 Prot., datë 08.10.2015, na informoi se, kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë është trajtuar nëpërmjet shkresës nr. 3613, datë 18.03.2015. Në këtë shkresë është kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, si institucion përgjegjës në fushën e pagave në administratën publike, të përcjellë vlerësimin e propozimit të paraqitur në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu ai na informoi se ka dijeni që, Departamenti i Administratës Publike ka argumentuar arsyet e mosndërmarrjes së këtij propozimi dhe ka njoftuar për këtë Ministrinë e Drejtësisë.

Zoti Kryeministër,

Nga letërkëmbimi i institucionit tonë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave rezulton se, megjithëse pranohet ekzistenca e problemeve që lidhet me të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve, zgjidhja e tyre sorollatet me justifikime të ndryshme të cilat i përshkuam më lart.

Përderisa shkelja e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve është evidente edhe aktualisht, dhe ndërkohë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Financave dhe Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike nuk po reagojnë për zbatimin e rekomandimit të Avokatit të Popullit dhe zgjidhjen e tyre, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"*, në nenin 21/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit.... paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit"*

që ka shkaktuar shkeljen” dhe në nenin 23 të ligjit “Për Avokatin e Popullit, ku parashikohet se: “Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki”,

REKOMANDOJMË :

Ndërryrjen Tuaj dhe ushtrimin e kompetencave ligjore ndaj Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike për të bërë të mundur zbatimin dhe respektimin e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe konkretisht për:

1. Marrjen e menjëhershme të masave organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoritë e IEVP-ve për respektimin brenda afateve ligjore të të drejtës së punonjësve të Policisë së Burgjeve për kryerjen e lejeve vjetore të pa bëra dhe për kompensimin me pushime për orët shtesë të punës së kryer, ose në pa mundësi të bëhet kompensimi në vlerë i tyre.

2. Marrjen e masave të nevojshme dhe bërjen e propozimeve përkatëse Këshillit të Ministrave për rritjen e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të bërë të mundur respektimin e të drejtës për t’u pajisur e uniformë dhe dhënien e ushqimit punonjësve të Policisë së Burgjeve që nga koha e cënimit të tyre.

3. Marrjen e masave për përgatitjen dhe dërgimin në Këshillin e Ministrave të projektit të VKM me qëllim trajtimin e barabartë ekonomiko-financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit.

4. Marrjen e masave të nevojshme studimore dhe bërjen e propozimit përkatës Kryeministrit me qëllim ndryshimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Për masat që do të merren në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI